



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 1006 Prot.

Berat më, 09.04.2026

Lënda: Kërkesë për shpallje publike (të vendimeve për Rikuperimin me Forcë të Borxhit)

Drejtuar : DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE  
DEPARTAMENTIT TË ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORIT TË MONITORIMIT TË BORXHIT

Drejtuar : DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: "Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjja; Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra;  
"Pajtoni Bussines Center", kati 5. "

Bazuar në Nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe pikës 4 të Nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë": "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe...";

Kërkojmë shpalljen publike të vendimeve për Rikuperimin me Forcë të Borxhit doganor ndaj:

Operatorit ekonomik: "Kantina e Pijeve Skrapar", Nipt: K89205401H  
Vendimi Nr. 16 datë 27.03.2026, në shumën e penaltetit 50,000 Lekë  
Vendimi Nr. 17 datë 27.03.2026, në shumën e penaltetit 200,000 Lekë

Kjo kërkesë bëhet për faktin se operatorit nuk ka marrë njoftim në adresën e deklaruar dhe për vazhdimin e procedurave të tjera ligjore është e nevojshme shpallja publike dhe data e shpalljes publike.  
(Bashkëlidhur vendimet Nr.16 ,17 datë 27.03.2026 të Degës Doganore Berat.)

Ju falenderojmë për bashkëpunimin !

KRYETAR I DEGËS DOGANORE BERAT



Adresa: Ish Kombinati i Tekstileve, Berat

[www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 854/4 prot.

Berat, më 27. 03. 2026

NJOFTIM VENDIMI

Drejtuar subjektit: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H , Adresë : “Çorovodë, Skrapar”

Subjektit: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H është shpallur debitor ndaj Degës Doganore Berat me Vendimin Nr.23 datë 13.03.2026 që ka vendosur për operatorin të shpallet debitor për: Shumën e penaltetit 50,000 Lekë.

Në zbatim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar, VKM-së Nr 651, Datë 10.11.2017 “ Për dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018” Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve doganore dhe të akcizës” të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave:

Akti i konstatimit Nr. Serial 0006896 datë 13.02.2026 u njoftua me shkresë Nr.427/1 prot.datë 13.02.2026 .Konfirmuar marrja dijeni me konfermen postare RR 810 857 829 AA. Nuk ka patur observacion.

Është marrë nga Dega Doganore Berat Vendimi Nr.23 datë 13.03.2026 për Shumën e penaltetit : 50.000 Lekë,njoftuar përmes shërbimit postar “rekomandë me lajmërim marrje”, dërguar në adresën e deklaruar, me shkresat Nr.730/1,730/2 prot. datë 13.03.2026. Konfirmuar dorëzimi me RR 819 149 028 AA. Nuk ka observacion.

Në zbatim të pikës 2.1 të kaphullit VII të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papagura doganore dhe të akcizës”, Dega Doganore Berat ka nxjerrë Vendimin Nr. 16 datë 27.03.2026 “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/ të Akcizës.

Përmes Vendimit Nr. 16 datë 27.03.2026 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/të akcizës, Dega Doganore Berat ka vendosur ndaj subjektit: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H zbatimin e masave dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve te papaguara (sekuestro/maltrash/vlerash monetare/objekte ne pronësi, etj) për Shumën e penaltetit 50,000 Lekë.

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 854 prot.

Berat, më 27.03.2026

NJOFTIM

VENDIMI NR.16 Dt. 27.03.2026

PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR

Drejtuar subjektit: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H , Adresë : “Çorovodë, Skrapar”

Në zbatim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së Nr 651, Datë 10.11.2017 “ Për dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”, Udhezimit Nr. 15, datë 03.12.2018” Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve doganore dhe të akcizës” të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ju njoftojme se:

Dega Doganore Berat me Vendimin Nr.23 datë 13.03.2026 ka vendosur për subjektin:  
Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H  
Shumën e penaltetit : 50.000 Lekë

Nga konstatimi subjekti nuk ka depozituar rakordimin mujor (Aneksin 14) pranë Degës Doganore Berat. Për sa më sipër në zbatim të ligjit nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 35, VKM-së 612, datë 05.09.2012 “Për zbatimin e ligjit nr.61/2012” për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar, neni 85, është kryer kundravajtje e nenit 92 e ligjit nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, aplikohet masa e penaltetit 50,000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë.

Per këtë arsye nga doganierët e zyrës së mbikëqyrjes është mbajtur procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative Nr.Serial 0006896 datë 13.02.2026 ose Nr.427 Prot. datë 13.02.2026. Akti i konstatimit Nr. Serial 0006896 datë 13.02.2026 u njoftua me shkresë Nr.427/1 prot.datë 13.02.2026 me njoftimin: “Per sa me sipër ne zbatim te procedurave ligjore te parashikuar ne Ligjit Nr. 102 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 273 e vijues dhe ne zbatim te nenit 161 të VKM-së nr.651, datë 10.11.2017 “Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor”, keni të drejtë që brenda 10 diteve nga informimi, nga e nesërmyja e marrjes së njoftimit, për të paraqitur pretendimet/kundërshtimet (prova, mendimet etj) tuaja me shkrim në sekretarinë e Degës së Doganës Berat. Me përfundimin e afatit të lartpërmendur, Dega e Doganës Berat do të procedojë me marrjen e akteve administrative të lartpërmendur”.

Bashkëlidhur kopja e procesverbalit për verifikimin e kundravajtjes administrative të akcizës me Nr.Serial 0006896 ose Nr.427 prot dt.13.02.2026. Konfirmuar marrja e dijeni me konferencën postare RR 810 857 829 AA. Nuk ka patur observacion.

Është marrë nga Dega Doganore Berat Vendimi Nr.23 datë 13.03.2026 për Shumën e penaltetit : 50.000 Lekë. Është njoftuar përmes shërbimit postar "rekomandë me lajmërim marrje", dërguar në adresën e deklaruar, me shkresat Nr.730/1,730/2 prot. datë 13.03.2026. Konfirmuar dorëzimi me RR 819 149 028 AA. Nuk ka observacion.

Në zbatim të pikës 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", ku citohet: *"Kur debitori nuk ekzekuton vullentarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmeja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen e debitorit, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, Dega Doganore bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të Ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës. Ky vendim bëhet pjesë e dosjes së detyrimeve të papaguara";*

Dega Doganore Berat ka nxjerrë Vendimin Nr. 16 datë 27.03.2026 "Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/ të Akcizës.

Përmes Vendimit Nr.16 datë 27.03.2026 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/të akcizës, Dega Doganore Berat ka vendosur si më poshtë :

1. Sekuestrimin e vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit ose garantuesit/garantuesve.

2. Sekuestrimin e mallrave, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkasin debitorit ose garantuesit/garantuesve, i cili/të cilët ka/kanë detyrime kundrejt debitorit.

3. Kryerjen e sekuestrimit të mësipërm deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve për t'u paguar nga subjekti debitor : "Kantina e Pijeve Skrapar", Nipt: K89205401H të përcaktuar në Vendimin Nr.23 datë 13.03.2026 për Shumën e penaltetit : 50.000 Lekë.

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT

Xhujta Kati





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 851 prot.

Berat, më 27. 03. 2026

NJOFTIM VENDIMI

Drejtuar subjektit: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H , Adresë : "Çorovodë, Skrapar"

Subjekti: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H është shpallur debitor ndaj Degës Doganore Berat me Vendimin Nr.24 datë 13.03.2026 që ka vendosur për operatorin të shpallet debitor për: Shumën e penalitetit 200,000 Lekë.

Në zbatim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë ", i ndryshuar, VKM-së Nr 651, Datë 10.11.2017 " Për dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë", Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018" Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve doganore dhe të akcizës" të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave:

Raportin Përfundimtar Nr.24202/2 Prot. datë 10.02.2026 të Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës ose Nr.406/1 Prot., datë 12.02.2026 me aktet bashkëlidhur Dega Doganore Berat e ka njoftuar për fillimin e procedurës administrative operatorit : "Kantina e Pijeve Skrapar" me shkresë nr.406/2 date 13.02.2026 Konfirmuar marrja dijeni me konfermen postare RR 814 969 834 AA. Observacion nuk ka patur.

Është marrë nga Dega Doganore Berat Vendimi Nr. 24 datë 13.03.2026 për Shumën e penalitetit : 200.000 Lekë. është njoftuar përmes shërbimit postar "rekomande me lajmërim marrje", dërguar në adresën e deklaruar, me shkresat Nr.731/1, 731/2 prot. datë 13.03.2026. Konfirmuar dorëzimi me konfermen postare RR 814 443 080 AA. Nuk ka observacion Në zbatim të pikës 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papagura doganore dhe të akcizës", Dega Doganore Berat ka nxjerrë Vendimin Nr. 17 datë 27.03.2026 "Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/ të Akcizës.

Përmes Vendimit Nr. 17 datë 27.03.2026 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/të akcizës, Dega Doganore Berat ka vendosur ndaj subjektit: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H zbatimin e masave dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve te papaguara (sekuestro/mallrash/vlerash monetare/objekte ne pronësi, etj) për Shumën e penalitetit 200,000 Lekë.

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 85 Prot.

Berat, më 27.03.2026

NJOFTIM

VENDIMI NR.17 Dt. 27.03.2026

PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR

Drejtuar subjektit: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H, Adresë : "Çorovodë, Skrapar"

Në zbatim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, VKM-së Nr 651, Datë 10.11.2017 " Për dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë", Udhezimit Nr. 15, datë 03.12.2018" Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve doganore dhe të akcizës" të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ju njoftojme se:

Dega Doganore Berat me Vendimin Nr.24 datë 13.03.2026 ka vendosur për subjektin:

Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H

Penalitetin : 200,000 Lekë

Në zbatim të Program Kontrollit Nr.24202 Prot., datë 05.12.2025, të miratuar nga ZV.Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, si dhe në baze të nenëve 20, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe nenëve 57,67 dhe 68 të V.K.M Nr.612, të ndryshuar, nga Drejtoria e Kontrollëve të Akcizës pranë Departamentit të Akcizës, u ushtrua kontroll pranë operatorit ekonomik: "**Kantina e Pijeve Skrapar**" shpk me NIPT K89205401H, me autorizim akcize nr. AL2N120058000 dhe magazine fiskale me nr. AL03431200590 për prodhimin e produkteve të akcizes vere, raki dhe pije alkolike.

Grupi i kontrollit i përbërë nga Eriselda Vokshi (Përgjegjës sektori), Laureta Hibroj (Përgjegjës sektori) dhe Filisa Malaj (Specialist) në datën 11.12.2025 u paraqit pranë ambienteve të magazines fiskale, ku rezultoi të ishin të mbyllura. Nga komunikimi me telefon me përfaqësuesit e operatorit specialisteve të kontrollit ju bë me dije se në ambjentet e magazines fiskale nuk ndodhej asnjë punonjës apo drejtues i autorizuar i saj. Nga përshkrimi në aktin e konstatimit Nr. Serial 0024632 datë 06.02.2026 ose me Nr.406 Prot. datë 12.02.2026 operatori nuk shfaqti disponueshmëri për të ardhur dhe për të mundur ushtrimin e kontrollit.

Të gjendur në këto kushte, u njoftua Dega Doganore Berat, si autoriteti mbikqyres, për të bërë plumbosjen e ambienteve deri në momentin, që përfaqësuesit e operatorit të paraqiten dhe

të jenë të gatshëm për ushtrimin e kontrollit. Dega Doganore Berat ne prani të punonjësit të mbikqyrjes së objektit kreu plumbosjen e ambienteve sipas PV nr.0000918 datë 11.12.2025.

Nisur nga ky fakt grupi i kontrollit gjykoj se operatori nuk u tregua i disponueshem, duke mos lejuar ushtrimin e kompetencave te autoritetit doganor. Depozituesi i miratuar "Kantina e Pijeve Skrapar" nuk dha argumenta bindës lidhur me mosdisponimin e tij, ndaj ushtrimit te kontrollit te autoriteteve doganore, duke shkelur nenin 20 pika 3/d te Ligjit Nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndyshuar:

*Neni 20 -Autorizimi dhe detyrimet e depozituesit të miratuar*

*3. Depozituesi i miratuar është i detyruar:*

*d) t'u mundësojë autoriteteve doganore, me kërkesën më të parë, kontrollin mbi mallrat dhe dokumentet;*

Për shkeljen e konstatuar grupi i kontrollit propozon penaltitet në masën 200,000 Lekë, në zbatim të Nenit 93/1 të Ligjit Nr.61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndyshuar. Nga specialistët e Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës të Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave u mbajt Proçesverbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative të akcizës Nr. Serial 0024632 datë 06.02.2026 ose me Nr.406 Prot. datë 12.02.2026 hyrje në Degën Doganore Berat.

Raportin Përfundimtar Nr.24202/2 Prot. datë 10.02.2026 të Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës ose Nr.406/1 Prot., datë 12.02.2026 bashkë me aktet bashkëlidhur Dega Doganore Berat e ka njoftuar për fillimin e procedurës administrative operatorit : "Kantina e Pijeve Skrapar" me shkresë nr.406/2 date 13.02.2026 me njoftimin: "...keni të drejtë që brenda 10 diteve nga informimi, nga e nesërmyja e marrjes së njoftimit, për të paraqitur pretendimet/kundërshtimet (prova, mendimet etj) tuaja me shkrim në sekretarinë e Degës së Doganës Berat. Me përfundimin e afatit, Dega e Doganës Berat do të procedojë me marrjen e akteve administrative të lartpërmendur". Konfirmuar marrja dijeni me konfermen postare RR 814 969 834 AA. Observacion nuk ka patur.

Është marrë nga Dega Doganore Berat Vendimi Nr. 24 datë 13.03.2026 për Shumën e penaltitetit : 200.000 Lekë, është njoftuar përmes shërbimit postar "rekomandë me lajmërim marrje", dërguar në adresën e deklaruar, me shkresat Nr.731/1, 731/2 prot. datë 13.03.2026. Konfirmuar dorëzimi me konfermen postare RR 814 443 080 AA. Nuk ka observacion.

Në zbatim të pikës 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", ku citohet: "Kur debitori nuk ekzekuton vullentarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmyja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, Dega Doganore bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të Ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës. Ky vendim bëhet pjesë e dosjes së detyrimeve të papaguara";

Dega Doganore Berat ka nxjerrë Vendimin Nr. 17 datë 27.03.2026 "Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/ të Akcizës.

Përmes Vendimit Nr.17 datë 27.03.2026 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/të akcizës, Dega Doganore Berat ka vendosur si më poshtë :

1. Sekuestrimin e vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit ose garantuesit/garantuesve.

2. Sekuestrimin e mallrave, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkasin debitorit ose garantuesit/garantuesve, i cili/të cilët ka/kanë detyrime kundrejt debitorit.

3. Kryerjen e sekuestrimit të mësipërm deri në masën që të behet i mundur plotësimi i detyrimeve për t'u paguar nga subjekti debitor : "Kantina e Pijeve Skrapar", Nipt: K89205401H të përcaktuar në Vendimin Nr.24 datë 13.03.2026 për Shumën e penaltetit : 200,000 Lekë.

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT

Xhulia Kati



	Marrësi nuk gjendet. Shkresa e njoftimit u dorëzua.	Marrësi/personat e tjerë të përcaktuar nga ligji refuzojnë të nënshkruajnë
Firma e marrësit (ose në rastin e personit juridik përfaqësuesit)	Firma e _____	Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari
	Shënimi lidhjen e këtij personi me marrësin	Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari